



USHTRIA



Viti i 82-të i botimit Nr. 22 (827978)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 5 qershor 2026



“LISSUS” NGRE FLAMURIN NË MESDHE FORCA DETARE NË “FOCOPS-26”

» faqe 3



MINISTRI I MBROJTJES ERMAL NUFI DHE SHSHPFA, GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI NË SHAPE

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, Ermal Nufi, i shoqëruar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, zhvilloi një vizitë zyrtare në Shtabin Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE), ku u pritën nga Komandanti Suprem i Forcave Aleate në Evropë (SACEUR), gjeneral Alexis G. Grynkeuich. Takimi u përqendrua në rolin...

faqe 4



GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI NË KONFERENCËN E XIX TË SHEFAVE TË SHTABEVE TË BALLKANIT: BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE MBROJTJA CIVILE, NË FOKUS TË DISKUTIMEVE NË SELANIK

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në punimet e Konferencës së XIX të Shefave të Shtabeve të vendeve të Ballkanit për Bashkëpunimin Ushtarak (BCHOD's), e zhvilluar në Selanik të Greqisë. Konferenca mbledhi drejtuesit më të lartë ushtarakë të vendeve të rajonit për të diskutuar mbi sfidat aktuale të sigurisë...

faqe 5



PROFESOR BASHKIM ELBASANI: MATEMATIKA ËSHTË POEZIA E LOGJIKËS DHE MUZIKA E ARSYES

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Një jetë mes matematikës, dijes dhe formimit të brezave, “Shpërblimi më i madh janë sukseset e studentëve”. Në historinë e arsimit shqiptar ka personalitete që nuk vlerësohen vetëm për dijen dhe arritjet akademike, por për gjurmën... faqe 8

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi takon Zëvendëssekretaren e Përgjithshme të NATO-s: Shqipëria mbetet faktor stabiliteti në rajon

Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi, zhvilloi një takim me Zëvendëssekretaren e Përgjithshme të NATO-s, znj. Radmila Šekerinska, ku në qendër të diskutimeve ishin siguria në Ballkanin Perëndimor, angazhimi i Shqipërisë në Aleancë dhe përgatitjet për samitet e ardhshme të NATO-s.

Gjatë takimit, ministri Nufi rikonfirmoi vendosmërinë e Shqipërisë për të mbetur një faktor konstruktiv dhe stabiliteti në Evropën Juglindore, duke mbështetur paqen, sigurinë dhe bashkëpunimin rajonal.

Në bashkëbisedim u nënvizua angazhimi i palëkundur i vendit tonë ndaj NATO-s dhe vlerave euroatlantike, si dhe përkushtimi për zbatimin e vendimeve të Samitit të Hagës në lidhje me rritjen e investimeve në mbrojtje.

Ministri Nufi theksoi se rritja e buxhetit të mbrojtjes do t'i japë Shqipërisë më shumë mundësi për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në Aleancë, duke forcuar njëkohësisht kapacitetet kombëtare të mbrojtjes.

Një vend të rëndësishëm në diskutime zuri edhe procesi i modernizimit të Forcave të Armatosura dhe rigjallërimi i industrisë vendase të mbrojtjes. Ministri Nufi vlerësoi zhvillimet pozitive në këtë drejtim, duke nënvizuar interesin në rritje të partnerëve ndërkombëtarë për bashkëpunim me industrinë shqiptare të mbrojtjes.

Palët diskutuan gjithashtu për përgatitjet e Samitit të NATO-s që do të zhvillohet në Ankara më 7-8 korrik, si dhe për organizimin e Samitit historik të NATO-s, në Tiranë në vitin 2027.

Ministri i Mbrojtjes vuri në dukje rëndësinë e kësaj ngjarjeje për Shqipërinë dhe për rolin e saj në Aleancë, duke theksuar se institucionet shqiptare janë të angazhuara maksimalisht për përgatitjen e këtij samiti.

Gjatë takimit u trajtua edhe çështja e sigurisë kibernetike. Ministri Nufi nënvizoi se Shqipëria mbetet e përkushtuar në forcimin e kapaciteteve të mbrojtjes kibernetike në bashkëpunim të ngushtë me NATO-n dhe vendet aleate, si pjesë e përpjekjeve për rritjen e qëndrueshmërisë dhe sigurisë kombëtare përballë sfidave të reja të mjedisit të sigurisë.

Takimi konfirmoi edhe një herë partneritetin e ngushtë mes Shqipërisë dhe NATO-s, si dhe rolin aktiv që vendi ynë vijon të luajë në përmbushjen e objektivave të Aleancës për sigurinë dhe stabilitetin euroatlantik.



Kursi i 21-të Komando, sfida e radhës për efektivët e Operacioneve Speciale

Program intensiv në Regjimentin e Operacioneve Speciale për testimin e qëndrueshmërisë, disiplinës dhe aftësive operacionale të kursantëve.

Në Regjimentin e Operacioneve Speciale u zhvillua Kursi i 21-të Komando, një nga programet më sfiduese të përgatitjes ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Kursi u zhvillua sipas një programi intensiv, i cili kombinon ngarkesa të larta fizike dhe psikologjike, me qëllim testimin dhe përgatitjen e pjesëmarrësve për përmbushjen me sukses të detyrave dhe misioneve operacionale. Gjatë fazave të ndryshme të stërvitjes, kursantët u përballën me prova që kërkojnë qëndrueshmëri të lartë fizike, disiplinë, vendimmarrje të shpejtë, aftësi taktike dhe punë në ekip, elementë thelbësorë për personelin që synon të shërbejë në strukturat e operacioneve speciale. Kursi Komando konsiderohet një ndër programet më të rëndësishme për përgatitjen e efektivëve të Forcave të Armatosura, pasi synon të identifikojë dhe zhvillojë aftësitë profesionale, morale dhe karakteriale të pjesëmarrësve në kushte të ngjashme me ato të misioneve reale. Përmes këtij programi, Regjimenti i Operacioneve



Speciale vijon të forcojë kapacitetet e tij njerëzore dhe operacionale, duke garantuar përgatitjen e personelit të aftë për të vepruar në mjedise komplekse dhe sfiduese, në përmbushje të misioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kursi i 21-të Komando është një tjetër dëshmi e përkushtimit të Forcave të Armatosura për të investuar në përgatitjen profesionale të efektivëve dhe rritjen e gatishmërisë operacionale të strukturave elitare të mbrojtjes.

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, z. Ermal Nufi, zhvilloi një takim me z. Guglielmo Picchi, President i Agjencisë Shtetërore Italiane për Kreditimin e Eksporteve (SACE), ku u diskutua mbi mundësitë e bashkëpunimit në mbështetje të projekteve strategjike në sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë.

Gjatë takimit, vëmendje e veçantë iu kushtua mbështetjes së projekteve që lidhen me modernizimin e kapaciteteve mbrojtëse, inovacionin teknologjik dhe zhvillimin e sektorit të sigurisë, në përputhje me prioritetet e Shqipërisë për forcimin e kapaciteteve kombëtare të mbrojtjes.

Palët diskutuan gjithashtu mbi instrumentet financiare dhe mekanizmat garantues që ofron SACE për mbështetjen e investimeve me interes të përbashkët, duke krijuar mundësi të reja për realizimin e projekteve strategjike dhe për zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik dhe industrial ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë.

Ministri Nufi vlerësoi rëndësinë e partneritetit me institucionet financiare dhe zhvillimore të vendeve aleate, duke theksuar se investimet në teknologji, inovacion dhe industri mbrojtjeje janë elementë kyç për rritjen e sigurisë dhe qëndrueshmërisë kombëtare.

“Shqipëria mbetet e përkushtuar në forcimin e partneriteteve me vendet aleate dhe institucionet që kontribuojnë në rritjen e sigurisë, zhvillimit ekonomik dhe kapaciteteve mbrojtëse të vendit”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Takimi me drejtuesin e SACE vjen në kuadër të përpjekjeve për zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes dhe për tërheqjen e instrumenteve financiare që mbështesin projektet strategjike të modernizimit të Forcave të Armatosura dhe zhvillimit të industrisë së mbrojtjes në Shqipëri.



Ministri Nufi takon Presidentin e SACE: Fokus, modernizimi dhe investimet në sektorin e mbrojtjes



“LISSUS” NGRE FLAMURIN NË MESDHE FORCA DETARE NË “FOCOPS-26”

Nga Porti i Durrësit u përcoll anija “Lissus” e Forcës Detare të Republikës së Shqipërisë, e cila do të marrë pjesë në misionin ndërkombëtar “FOCOPS-26” në Detin Mesdhe.

Pjesëmarrja në këtë mision përbën një tjetër kontribut të rëndësishëm të Shqipërisë në kuadër të përpjekjeve për forcimin e sigurisë detare, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe garantimit të stabilitetit në hapësirën mesdhetare. Misioni “FOCOPS-26” synon rritjen e ndërveprueshmërisë ndërmjet forcave detare të vendeve partnere, shkëmbimin e përvojave operationale dhe forcimin e kapaciteteve për përballimin e sfidave të sigurisë në mjedisin detar.

Në ceremoninë e nisjes së anijes “Lissus” morën pjesë përfaqësues të institucioneve qendrore dhe vendore, si dhe autoritete të sektorit detar. Ndër të pranishmit ishte edhe Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit Portual Durrës, i cili vlerësoi rolin e Forcës Detare në përmbushjen e misioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Pjesëmarrja e Forcës Detare shqiptare në operatione dhe stërvitje shumëkombëshe dëshmon angazhimin e vazhdueshëm të Forcave të Armatosura për të kontribuar në sigurinë kolektive, si dhe për të rritur nivelin e gatishmërisë dhe profesionalizmit të personelit detar.

Anija “Lissus” dhe ekuipazhi i saj do të operojnë së bashku me njësi të forcave detare partnere, duke përfaqësuar denjësisht Forcën Detare dhe Republikën e Shqipërisë në këtë mision të rëndësishëm ndërkombëtar.



Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, Ermal Nufi, i shoqëruar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralletjënant Arben Kingji, zhvilloi një vizitë zyrtare në Shtabin Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE), ku u pritën nga Komandanti Suprem i Forcave Aleate në Evropë (SACEUR), gjeneral Alexis G. Grynkeuich.

Takimi u përqendrua në rolin dhe kontributin e rëndësishëm të Shqipërisë në përmbushjen e detyrimeve ndaj Aleancës, si dhe në angazhimet kombëtare për forcimin e kapaciteteve operacionale në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Gjatë bisedimeve, ministri Nufi theksoi se partneriteti mes Shqipërisë dhe NATO-s mbetet një gur themeli i sigurisë kombëtare dhe rajonale, ndërsa nënvizoi angazhimin e vendit tonë për mbrojtjen kolektive dhe përmbushjen e objektivave të Aleancës në një mjedis gjithnjë e më sfidues të sigurisë.

Në takim u vlerësua gjithashtu roli në rritje i Shqipërisë në strukturat vendimmarrëse, operacionale dhe strategjike të NATO-s, si dhe profesionalizmi i Forcave të Armatosura shqiptare në misionet dhe operacionet ndërkombëtare.

“Përfaqësimi i Shqipërisë në nivelet më të larta të komandimit të NATO-s është tashmë një realitet i prekshëm që dëshmon pjekurinë profesionale të Forcave tona të Armatosura dhe besimin që aleatët kanë ndaj Shqipërisë, si një vend që kontribuon aktivisht në sigurinë kolektive euroatlantike. Mbështetja e vazhdueshme e Aleatëve mbetet kyçe për forcimin e kapaciteteve tona mbrojtëse dhe rritjen e gatishmërisë operacionale”, - u shpreh ministri Nufi.

Nga ana e tij, gjeneralletjënant Arben Kingji riafirmoi angazhimin e Forcave të Armatosura për të rritur ndërpërveshmërinë me strukturat e NATO-s, duke vijuar procesin e modernizimit dhe rritjes së gatishmërisë operacionale në përputhje me standardet e Aleancës.

Pjesë e diskutimeve ishin edhe projektet strategjike që Shqipëria po zhvillon në mbështetje të sigurisë rajonale dhe të NATO-s, përfshirë Bazën Detare të Porto Romanos dhe rëndësinë e Korridorit VIII për mobilitetin ushtarak dhe lëvizjen e forcave aleate.

Palët ndanë vlerësime mbi situatën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor, duke theksuar nevojën për koordinim të vazhdueshëm mes aleatëve përballë kërcënimeve hibride, sulmeve kibernetike dhe ndikimeve destabilizuese në rajon.

Në këtë kuadër, Shqipëria shprehu gatishmërinë për të vijuar dhe zgjeruar kontributin e saj në operacionet e NATO-s, përfshirë misionin KFOR në Kosovë dhe EUFOR ALTHEA në Bosnje-Hercegovinë.

Gjatë takimit u diskutua gjithashtu përgatitja e Shqipërisë për organizimin e Samitit të NATO-s në Tiranë vitin e ardhshëm, një ngjarje me rëndësi strategjike për vendin dhe Aleancën.

SHAPE, me seli në Mons të Belgjikës, është qendra kryesore operacionale e NATO-s dhe institucioni përgjegjës për planifikimin strategjik, drejtimin operacional dhe koordinimin shumëkombësh të forcave aleate në Evropë.

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi dhe SHSHHPFA, Gjeneralletjënant Arben Kingji në SHAPE

Diskutime me Komandantin Suprem të Forcave Aleate në Evropë mbi forcimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe kontributin e Shqipërisë në NATO



Ministri i Mbrojtjes Nufi në Itali: Shqipëria dhe Italia intensifikojnë bashkëpunimin strategjik në fushën e mbrojtjes

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, z. Ermal Nufi, zhvilloi një vizitë zyrtare në Itali, ku u prit nga homologu i tij italian, ministri i Mbrojtjes, z. Guido Crosetto.

Gjatë takimit, të dy ministrat rikonfirmuan angazhimin e përbashkët për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve strategjike dhe zgjerimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Ministri Nufi vlerësoi partneritetin e ngushtë dhe të veçantë mes Shqipërisë dhe Italisë, duke theksuar rëndësinë e koordinimit të përbashkët për përballimin e sfidave të sigurisë në hapësirën Adriatiko-Joniane, në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropën Juglindore.

Sipas ministrit shqiptar, këto rajone mbeten me rëndësi strategjike për sigurinë euroatlantike, ndërsa Shqipëria vijon të japë një kontribut aktiv në kuadër të mbrojtjes kolektive të NATO-s dhe stabilitetit rajonal.

Një vend të rëndësishëm në diskutime zuri edhe bashkëpunimi në industrinë e mbrojtjes. Të dy ministrat nënvizuan se Shqipëria dhe Italia po hyjnë në një fazë të re të bashkëpunimit strategjik, pas marrëveshjes së nënshkruar mes shoqërisë shtetërore shqiptare “KAYO” dhe kompanisë italiane “Fincantieri” për prodhimin e mjeteve lundruese ushtarake.

Ky bashkëpunim konsiderohet një hap i rëndësishëm në modernizimin e kapaciteteve detare të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe në zhvillimin e industrisë kombëtare të mbrojtjes, duke krijuar mundësi të reja për transferimin e teknologjisë, rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe forcimin e bashkëpunimit industrial mes dy vendeve.

Gjatë takimit u diskutua gjithashtu për rolin e Shqipërisë brenda Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe përgatitjet për Samitin e NATO-s, i cili do të zhvillohet në Tiranë vitin e ardhshëm.



Ministri Nufi informoi homologun italian mbi masat e ndërmarra për organizimin e këtij eventit historik për vendin tonë, duke theksuar se tashmë ka nisur puna përmes ngritjes së Task-Forcës dhe Skuadrës Kombëtare të Organizimit të Samitit. Të dy ministrat vlerësuan bashkëpunimin e shkëlqyer mes Shqipërisë dhe Italisë në kuadër të NATO-s, si dhe rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve në fushat e sigurisë, mbrojtjes, trajnimit ushtarak dhe modernizimit të kapaciteteve operative.

Takimi konfirmoi edhe një herë partneritetin strategjik mes dy vendeve aleate dhe vullnetin e përbashkët për të kontribuar në sigurinë, stabilitetin dhe mbrojtjen e hapësirës euroatlantike.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në punimet e Konferencës së XIX të Shefave të Shtabeve të vendeve të Ballkanit për Bashkëpunimin Ushtarak (BCHOD's), e zhvilluar në Selanik të Greqisë.

Konferenca mbledhi drejtuesit më të lartë ushtarakë të vendeve të rajonit për të diskutuar mbi sfidat aktuale të sigurisë, zhvillimet në mjedisin strategjik rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe forcimin e bashkëpunimit ushtarak ndërmjet vendeve të Ballkanit.

Punimet e këtij viti u zhvilluan me temën **“Sfidat dhe Inovacioni në Mbrojtjen Civile: Përshtatja ndaj realiteteve të reja të luftës”**, duke vënë theksin tek rëndësia e mbrojtjes së civilëve në të gjitha fazat e planifikimit dhe zbatimit të operacioneve ushtarake, si dhe tek nevoja për një koordinim më të ngushtë ndërmjet strukturave ushtarake dhe atyre civile.

Gjatë diskutimeve, gjenerallejtënant Kingji theksoi rëndësinë e forcimit të kapaciteteve për mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe përbashkëpunimin e kërcënimeve të reja që karakterizojnë mjedisin aktual të sigurisë.

Në fjalën e tij, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm vlerësoi progresin e arritur ndër vite në forcimin e bashkëpunimit rajonal, duke nënvizuar rëndësinë e orientimit euroatlantik të vendeve të Ballkanit dhe rolin që strukturat ndërkombëtare të sigurisë luajnë në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon.

Gjenerallejtënant Kingji vuri në dukje kontributin e rëndësishëm të misioneve ndërkombëtare **KFOR** në Kosovë dhe **EUFOR ALTHEA** në Bosnje-Hercegovinë, të cilat vazhdojnë të mbeten faktorë kyç për sigurinë dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor.

Në kuadër të konferencës, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm zhvilloi edhe një takim dypalësh me homologun e tij grek, shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura të Greqisë, Gjeneral Dimitrios Choupis.

Gjatë takimit, palët shkëmbyen vlerësime mbi situatën aktuale të sigurisë në rajon dhe diskutuan mbi vijimin e bashkëpunimit ushtarak ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë, me fokus forcimin e sigurisë, stabilitetit dhe ndërveprueshmërisë ndërmjet forcave të armatosura të dy vendeve aleate.

Gjenerallejtënant Kingji shprehu mirënjohjen për mikpritjen e autoriteteve greke dhe riafirmoi angazhimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për zgjerimin e bashkëpunimit rajonal, rritjen e kapaciteteve të përbashkëta dhe përmbushjen e objektivave të NATO-s në



Gjenerallejtënant Arben Kingji në Konferencën e XIX të Shefave të Shtabeve të Ballkanit: Bashkëpunimi rajonal dhe mbrojtja civile, në fokus të diskutimeve në Selanik



funkcion të sigurisë kolektive.

Konferenca e Shefave të Shtabeve të vendeve të Ballkanit mbetet një nga forumet më të rëndësishme të bashkëpunimit



ushtarak rajonal, duke kontribuar në ndërtimin e besimit, shkëmbimin e përvojave dhe koordinimin e përbashkët përballë sfidave të sigurisë.



Tallinn, Estoni – Shqipëria shënoi një tjetër arritje të rëndësishme në fushën e sigurisë kibernetike, duke marrë pjesë për herë të parë si shtet me të drejta të plota në Komitetin Drejtues të Qendrës së Ekselencës për Mbrojtjen Kibernetike Bashkëpunuese të NATO-s (CCDCOE).

Gjatë qëndrimit në Tallinn, delegacioni i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i kryesuar nga Komandanti i Komandës Kombëtare Kibernetike (KKN) dhe Komandanti i Qendrës Operacionale Kibernetike (QOK), mori pjesë në aktivitetet e rëndësishme ndërkombëtare **Cyber Commanders Forum 2026 (CCF26)** dhe **Cyber Conflict Conference 2026 (CyCon26)**.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në Komitetin Drejtues të CCDCOE si anëtare me të drejta të plota përbën një hap domethënës në rritjen e rolit të vendit tonë në arkitekturën e sigurisë kibernetike të NATO-s. Ky status i ri i jep Shqipërisë mundësinë të kontribuojë drejtpërdrejt në proceset vendimmarrëse të qendrës më të rëndësishme të Aleancës në fushën e mbrojtjes kibernetike.

Në kuadër të punimeve të **Cyber Commanders Forum 2026**, drejtuesit e strukturave kibernetike të vendeve aleate diskutuan mbi sfidat aktuale të sigurisë në hapësirën kibernetike, operacionet mbrojtëse, zhvillimin e kapaciteteve të përbashkëta dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet vendeve anëtare të NATO-s.

Gjatë aktivitetit u zhvillua gjithashtu një takim me Drejtorin e CCDCOE, z. Tonis Saar, ku u riafirmua angazhimi i Shqipërisë për zgjerimin e bashkëpunimit me qendrën dhe për forcimin e rolit të saj në përballimin e sfidave kibernetike që prekin sigurinë kolektive të Aleancës.

Pjesëmarrja aktive në forumet dhe strukturat e NATO-s në fushën e sigurisë kibernetike dëshmon përkushtimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për zhvillimin e kapaciteteve moderne të mbrojtjes, rritjen e ndërveprueshmërisë me aleatët dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në Aleancën e Atlantikut të Veriut.

Ky zhvillim përforcon pozicionin e Shqipërisë si një kontribuuese aktive në sigurinë kibernetike euroatlantike dhe në mbrojtjen e infrastrukturave kritike përballë kërcënimeve të reja të mjedisit digjital.



Shqipëria merr për herë të parë statusin e plotë vendimmarrës në CCDCOE - Forcohet roli i vendit në strukturat kibernetike të NATO-s



Regjimenti i Këmbësores së Veriut përmbyll me sukses stërvitjen taktike, rritet gatishmëria luftarake

Regjimenti i Këmbësores së Veriut (b1k dhe b3k) e mbylli javën stërvitore me realizimin me sukses të një marshimi taktik prej 18 kilometrash, në kuadër të programit të rregullt të përgatitjes luftarake.

Ky aktivitet stërvitor konfirmoi nivelin e lartë të përgatitjes fizike dhe taktike të efektivave të regjimentit, si dhe rritjen e vazhdueshme të kapaciteteve operacionale të Forcës Tokësore, në përputhje me standardet e NATO-s.

Marshimi taktik u zhvillua në kushte që kërkojnë disiplinë, koordinim dhe qëndrueshmëri të lartë fizike, duke vënë në provë aftësitë e reagimit të shpejtë dhe bashkëveprimin luftarak të njësive pjesëmarrëse.

Sipas autoriteteve ushtarake, çdo stërvitje e tillë përforcon më tej gatishmërinë luftarake dhe aftësinë për përmbushjen e detyrave në çdo situatë operacionale.

Forca Tokësore mbetet e angazhuar në rritjen e vazhdueshme të efektivitetit operacional, profesionalizmit dhe gatishmërisë së lartë luftarake të trupave të saj.



NJË UNIFORMË MË PAK, NJË PLAGË MË SHUMË PËR SHOQËRINË

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Ka ngjarje që tronditin një familje. Ka ngjarje që prekin një institucion. Por ka edhe ngjarje që prekin vetë ndërgjegjen kombëtare. Vrasja e një punonjësi policie në krye të detyrës është një prej tyre.

Në pamje të parë duket si një lajm i kronikës së zezë. Një tjetër ngjarje e rëndë që zë vend në titujt e mediave dhe më pas humbet mes zhvillimeve të tjera të ditës. Por në të vërtetë nuk është kështu. Kur humbet jetën një efektiv i Policisë së Shtetit gjatë përmbushjes së detyrës, humbet një njeri që kishte zgjedhur t'i shërbente vendit. Humbet një profesionist që kishte vendosur sigurinë e qytetarëve mbi sigurinë e vet. Humbet një bir, një bashkëshort, një prind, një koleg dhe një qytetar që mbante mbi supe barrën e përgjegjësisë publike.

Sot një nënë qan djaln e saj. Një familje është zhytur në dhimbje. Një institucion ka humbur një pjesëtar të vetin. Por bashkë me ta duhet të reflektojë e gjithë shoqëria shqiptare.

Në çdo shtet demokratik, siguria publike është një nga shtyllat themelore të jetës së qytetarëve. Policia, Forcat e Armatosura, shërbimet e emergjencës dhe të gjitha strukturat e sigurisë ekzistojnë për të garantuar rendin, qetësinë dhe mbrojtjen e interesit publik. Njerëzit që shërbejnë në këto institucione nuk kryejnë thjesht një profesion; ata marrin përsipër një mision.

Ky mision shpesh është i vështirë, i lodhshëm dhe i rrezikshëm. Ai kërkon sakrifica që qytetarët e zakonshëm jo gjithmonë i shohin. Kërkon net pa gjumë, largim nga familja, gatishmëri të vazhdueshme dhe, në raste ekstreme, edhe flijimin e jetës.

Pikërisht për këtë arsye, kur një efektiv bie në krye të detyrës, ai nuk duhet parë vetëm si humbje individuale. Ai është simbol i çmimit që paguhet për sigurinë dhe rendin që ne gëzojmë çdo ditë.

Uniforma nuk është thjesht veshje

Në traditën ushtarake dhe në kulturën e institucioneve të sigurisë, uniforma nuk është vetëm një veshje pune. Ajo përfaqëson përgjegjësi, disiplinë, sakrificë dhe nder.

Çdo efektiv policie, çdo ushtarak, çdo oficer apo nën-officer që vesh uniformën merr përsipër një kontratë morale me shoqërinë. Ai betohet se do të mbrojë ligjin, rendin, sovranitetin dhe qytetarët, edhe kur kjo mund ta vendosë përballë rrezikut.

Kjo është arsyeja pse institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes gëzojnë respekt të veçantë në çdo vend të botës. Sepse pas uniformës nuk qëndron vetëm individi, por vetë shteti.

Kur goditet një përfaqësues i ligjit në krye të detyrës, në një farë mënyre sfidohen edhe vlerat mbi të cilat ngrihet bashkëjtesa demokratike.

Një shoqëri që duhet të reflektojë

Ngjarje të tilla na detyrojnë të bëjmë një analizë më të thellë të realitetit tonë shoqëror. *Pse po rritet agresiviteti? Pse po zbehet respekti për institucionet?*

Pse konfliktet po marrin forma gjithnjë e më të rrezikshme?



Këto nuk janë pyetje që kërkojnë përgjigje vetëm nga organet e rendit. Janë pyetje që kërkojnë reflektim nga familja, shkolla, komuniteti dhe secili prej nesh.

Dhuna nuk lind brenda natës. Ajo ushqehet nga mungesa e edukimit, nga indiferenca, nga humbja e vlerave dhe nga normalizimi i gjuhës së urrejtjes.

Nëse duam një shoqëri më të sigurt, duhet të investojmë më shumë te kultura qytetare, te edukimi dhe te respekti për ligjin.

Mësimi që japin Forcat e Armatosura

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë qenë historikisht një shkollë disipline, përgjegjësie dhe patriotizmi.

Brenda tyre, breza të tërë ushtarakësh janë formuar me bindjen se interesi i vendit qëndron mbi interesin personal. Ata janë edukuar me ndjenjën e detyrës, me respektin për institucionin dhe me gatishmërinë për të sakrifikuar në shërbim të kombit.

Këto vlera mbeten aktuale edhe sot.

Në një kohë kur bota përballet me sfida të reja sigurie, me konflikte rajonale, kërcënime hibride dhe kriza të ndryshme, nevoja për qytetarë të përgjegjshëm dhe për profesionistë të përkushtuar është më e madhe se kurrë.

Forcat e Armatosura dhe Policia e Shtetit kanë misione të ndryshme, por ndajnë të njëjtat vlera themelore: disiplinën, integritetin, shërbimin dhe përkushtimin ndaj atdheut.

Sakrifica nuk duhet harruar

Historia e çdo kombi është ndërtuar mbi sakrificat e njerëzve të tij. Disa kanë rënë në luftë për mbrojtjen e lirisë. Të tjerë kanë humbur jetën në krye të detyrës për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë. Detyrimi ynë moral është të mos i harrojmë. Kujtesa kolektive është forma më fisnike e mirënjohjes. Kur kujtojmë ata që kanë shërbyer me ndershmëri dhe kanë sakrifikuar për të tjerët, ne forcojmë

vlerat mbi të cilat ndërtohet një shoqëri e shëndetshme.

Sot nderojmë një efektiv policie që humbi jetën në krye të detyrës. Nesër mund të kujtojmë një ushtarak, një zjarrfikës, një mjek apo një qytetar që ka vënë interesin publik mbi interesin personal.

Ata janë njerëzit që mbajnë në këmbë shoqërinë.

Një mesazh për brezin e ri

Të rinjtë shqiptarë kanë nevojë për modele pozitive. Kanë nevojë të kuptojnë se suksesi nuk matet vetëm me pasurinë apo famën. Ai matet edhe me kontributin që jep për vendin dhe për njerëzit.

Uniforma, qoftë ajo e Policisë së Shtetit apo e Forcave të Armatosura, mbetet një simbol i këtij kontributi.

Ajo përfaqëson detyrën, ndershmërinë, disiplinën dhe sakrificën.

Në një kohë kur shoqëria ka nevojë për më shumë solidaritet dhe përgjegjësi, këto vlera janë më të rëndësishme se kurrë.

Nderim për sakrificën

Sot, përpara dhimbjes së një familjeje shqiptare, fjalët janë të pamjaftueshme.

Por ajo që mund të bëjmë është të reflektojmë, të nderojmë kujtimin e të ndjerit dhe të kuptojmë se siguria nuk është një e mirë e garantuar. Ajo ndërtohet çdo ditë nga njerëz që shërbejnë me përkushtim, shpesh larg vëmendjes së publikut.

Kur bie në detyrë një shërbëtor i atdheut, nuk duhet të qajë vetëm familja e tij.

Duhet të reflektojë e gjithë shoqëria.

Pas çdo uniforme ndodhet një njeri. Pas çdo njeriu ndodhet një familje.

Pas çdo sakrifice, një mësim që nuk duhet harruar kurrë, se shërbimi ndaj atdheut është ndër format më të larta të dinjitetit njerëzor.

Profesor Bashkim Elbasani: Matematika është poezia e logjikës dhe muzika e arsyes



Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Një jetë mes matematikës, dijes dhe formimit të brezave, “Shpërblimi më i madh janë sukseset e studentëve”

Në historinë e arsimit shqiptar ka personalitete që nuk vlerësohen vetëm për dijen dhe arritjet akademike, por për gjurmën e thellë që lënë në edukimin dhe formimin e brezave. Një prej këtyre figurave të rralla është Prof. Dr. Bashkim Elbasani, një emër i respektuar në fushën e matematikës shqiptare, i cili për më shumë se pesë dekada ia ka kushtuar jetën arsimit, shkencës dhe mësimdhënies.

Pedagog, autor i dhjetëra teksteve universitare dhe shkollore, studiues dhe drejtues i trajnimeve pedagogjike në mbarë vendin, profesor Bashkimi ka ndikuar drejtpërdrejt në formimin profesional dhe njerëzor të qindra studentëve e mësuesve.

Përkushtimi, serioziteti dhe pasioni i tij për dijen vazhdojnë të mbeten një model frymëzimi edhe sot, ndërsa ai vijon të kontribuojë në Akademinë e Forcave të Armatosura.

I nderuar së fundmi me titullin “Qytetar Nderi i Krujës”, profesor Bashkim Elbasani mbetet një simbol i intelektualit të përkushtuar, që profesionin e ka kthyer në mision.

Profesor Bashkimi, si e përjetuat momentin kur u nderuat me titullin “Qytetar Nderi i Krujës”?

Siç them shpesh me humor, ishte “si qershia mbi tortë”. Ishte një emocion dhe kënaqësi e jashtëzakonshme. Për mua ka një vlerë të veçantë fakti që ky vlerësim vjen nga qyteti ku linda, u rrita dhe jetova për afro 50 vite.

Kruja nuk është thjesht vendlindja ime. Është qyteti heroik i Skënderbeut, qyteti që i dha identitet dhe krenari kombit shqiptar, qyteti që për 25 vite i rezistoi një prej perandorive më të fuqishme të kohës dhe bëri që Europa të kthente sytë nga Shqipëria.

Prandaj, të renditesh mes qytetarëve që kanë kontribuar për këtë qytet është një nder i madh. E ndjej si një vlerësim të sigurtë për gjithçka kam bërë për brezat e rinj, për arsimin dhe edukimin në Krujë gjatë gjithë jetës sime profesionale.

Çfarë do të thotë për ju të vlerësoheni nga qyteti juaj i lindjes pas një karriere kaq të gjatë akademike?

Çdo vlerësim të ngre moralin dhe të jep energji për të vazhduar më tej. Por kur vlerësimi vjen nga komuniteti ku ke jetuar, punuar dhe kontribuar për dekada, ai merr një dimension krejt tjetër.

Kam përjetuar shumë momente të bukura me ish-nxënësit dhe maturanët e brezave të ndryshëm. Takimet e 45-vjetorit dhe 50-vjetorit të maturës më kanë emocionuar veçanërisht. Kur sheh se nxënësit e tu kanë ruajtur respektin dhe mirënjohjen ndër vite, kupton se puna jote ka lënë gjurmë.

Vlerësimi nga qyteti është një gjykim kolektiv i komunitetit, i nxënësve, prindërve dhe qytetarëve. Kur ai vjen natyrshëm, pa kërkuar asgjë në këmbim, është ndoshta vlerësimi më i lartë që mund të marrë një mësues.

Gjatë mbi 54 viteve në arsim, cili ka qenë momenti më i veçantë në jetën tuaj profesionale?



Kam përjetuar shumë momente të bukura me ish-nxënësit dhe maturanët e brezave të ndryshëm. Takimet e 45-vjetorit dhe 50-vjetorit të maturës më kanë emocionuar veçanërisht. Kur sheh se nxënësit e tu kanë ruajtur respektin dhe mirënjohjen ndër vite, kupton se puna jote ka lënë gjurmë.

Ka pasur shumë momente të rëndësishme, por një prej tyre lidhet me vitet e vështira të tranzicionit.

Në vitin 1997, kur vendi përjetoj trazira të mëdha dhe shumë institucione u dëmtuan, si drejtues i arsimit në Krujë u angazhova bashkë me kolektivet pedagogjike për të mbrojtur shkollat. Ndërsa në shumë zona të vendit u dëmtuan ose u plaçkitën objekte arsimore, në Krujë të gjitha godinat shkollore mbetën të paprekura.

Për mua kjo mbetet një arritje e madhe, sepse tregoi kulturë qytetare dhe përgjegjësi kolektive. Ishte një fitore e arsimit dhe e komunitetit.

Si lindi pasioni juaj për matematikën dhe për mësimdhënien?

Në gjimnazin “Kruja” isha nxënës shumë i mirë dhe vazhdimisht merrja pjesë në konkurset kombëtare të matematikës, fizikës dhe kimisë.

Çdo tre muaj Ministria e Arsimit publikonte problemat më të mira dhe zgjidhjet më të sakta. Emrat e fituesve njiheshin në të gjithë vendin. Unë i zgjidhja rregullisht këto probleme dhe gradualisht matematika u bë pasioni im.

Një rol të veçantë pati profesori i nderuar Petraq Pilika, i cili asistoi në provimin tim të matematikës dhe më inkurajoi të ndiqja degën e Matematikës në Fakultetin e Shkencave

të Natyrës. Ishte një këshillë që përcaktoi gjithë jetën time profesionale.

Ju keni vendosur standarde kombëtare për kabinetet e matematikës. Sa e rëndësishme është infrastruktura në procesin e të nxënësve?

Misioni im ishte që nxënësit e Krujës të ishin ndër më të përgatiturit në matematikë dhe të suksesshëm në universitete.

Për këtë arsye krijova një kabinet funksional matematike me mjete që ndihmonin kuptimin e koncepteve abstrakte. Projektova “Tabelën Universale të Matematikës”, ku integroheshin vizore, raportorë, kompas dhe mjete të tjera didaktike.

Kabineti u vizitua nga mësues të matematikës nga e gjithë Shqipëria dhe Ministria e Arsimit rekomandoi përdorimin e këtyre modeleve në shkollat e mesme të vendit.

Rezultati ishte i dukshëm: rritje e cilësisë së mësimdhënies dhe rezultate shumë të mira të nxënësve.

Cilat kanë qenë sfidat më të mëdha të arsimit shqiptar ndër vite?

Ndryshimet e shumta shoqërore, ekonomike dhe politike kanë ndikuar drejtpërdrejt arsimin. Sfida kryesore ka qenë



Pasioni nuk injektohet dhe nuk mësohet. Ai është një forcë e brendshme që e shtyn njeriun të japë maksimumin. Një pedagog i mirë duhet ta dojë profesionin, studentët dhe dijen. Duhet të pyesë vazhdimisht veten: “Si do të doja unë të ma shpjegonin këtë temë po të isha student?”

ruajtja e cilësisë dhe seriozitetit të procesit mësimor. Arsimi ka nevojë për stabilitet, investim dhe vizion afatgjatë. Kur këto mungojnë, pasojat ndihen te brezat.

Çfarë e dallon një pedagog të mirë matematike nga të tjerët?

Pasioni.

Pasioni nuk injektohet dhe nuk mësohet. Ai është një forcë e brendshme që e shtyn njeriun të japë maksimumin. Një pedagog i mirë duhet ta dojë profesionin, studentët dhe dijen. Duhet të pyesë vazhdimisht veten: “Si do të doja unë të ma shpjegonin këtë temë po të isha student?”

Mësuesi i pasionuar kërkon mënyrën më të mirë për ta bërë dijen të kuptueshme. Mësuesi “rrogëtar” thjesht transmeton informacion pa u shqetësuar sa kuptohet ai.

Ju jeni autor i dhjetëra teksteve shkollore dhe universitare. Cili prej botimeve tuaja ka një vend të veçantë për ju?

Kam shkruar shumë tekste me bindjen se çdo student duhet të ketë në dorë materialin e duhur për të studiuar.

- Ndër botimet që vlerësoj më shumë janë:
- “Metoda Numerike në Shkencat Kompjuterike” për studentët Master;
 - “Calculus 1 & 2 (Analiza Matematike)” për studentët Bachelor;
 - “Algjebra” për vitin e parë Bachelor;
 - “Hyrje në Logjikën Formale Klasike” për studentët e Jurisprudencës.

Secili tekst ka rëndësinë e vet, por një vend të veçantë zë “Calculus 1 & 2”, sepse është përgatitur me shumë kujdes, me ilustrime dhe figura me ngjyra për të lehtësuar të kuptuarit.

Si ka evoluar mënyra e mësimdhënies së matematikës nga fillimi i karrierës suaj deri sot?

Ka ndryshuar shumë. Dikur mbështeteshim kryesisht te tabela dhe teksti. Sot teknologjia ka sjellë mundësi të

jashtëzakonshme për vizualizim, simulim dhe ndërveprim. Megjithatë, thelbi mbetet i pandryshuar: të zhvillosh logjikën dhe aftësinë për të menduar.

Matematika kërkon logjikë, disiplinë dhe qëndrueshmëri. Sa të rëndësishme janë këto elemente në formimin e një oficeri të ardhshëm?

Shumë të rëndësishme. Më pëlqen të citoj thënien: “Matematika është poezia e logjikës dhe muzika e arsyes”. Matematika kultivon vëmendjen, analizën, arsyetimin, përqendrimin dhe saktësinë. Ajo të mëson të lexosh me kujdes, të kuptosh problemin, të analizosh të dhënat dhe të arrish në përfundime të sakta. Të gjitha këto cilësi i duhen edhe një oficeri të mirë.

Ju vazhdoni të jepni mësim në Akademinë e Forcave të Armatosura. Çfarë e bën të veçantë këtë eksperiencë?

Studentët ushtarakë karakterizohen nga disiplina, korrektësia dhe përgjegjshmëria. Puna me ta është motivuese, sepse ata kanë objektiva të qarta dhe ndjejnë përgjegjësinë e profesionit që kanë zgjedhur.

Si e vlerësoni nivelin akademik dhe përkushtimin e studentëve të Akademisë?

Në përgjithësi pozitivisht. Ata tregojnë seriozitet, disiplinë dhe dëshirë për të mësuar. Sigurisht ka gjithmonë vend për përmirësim, por niveli është inkurajues.

Sa ndikojnë lojërat logjike dhe rebuset matematike në zhvillimin analitik të studentëve?

Ndikojnë jashtëzakonisht shumë. Lojërat logjike e mbajnë trurin aktiv, zhvillojnë imagjinatën, aftësinë analitike dhe kreativitetin. Ato e bëjnë matematikën më tërheqëse dhe më të dashur për studentët. Për këtë arsye kam qenë gjithmonë mbështetës i përdorimit të tyre në procesin mësimor.

Cili ka qenë sekreti juaj për të ruajtur energjinë dhe pasionin për auditorin?

Dashuria për profesionin. Kur e do atë që bën, energjia rinovohet vazhdimisht. Çdo brez i ri studentësh sjell motivim të ri dhe sfida të reja.

Çfarë këshille do t’u jepnit pedagogëve të rinj?

Ta bëjnë mësimdhënien interesante. Studentët duhet ta kuptojnë se matematika nuk është vetëm një lëndë për të kaluar provimin, por një mënyrë të menduari që ndihmon gjatë gjithë jetës. Pedagogu duhet të frymëzojë, jo vetëm të informojë.

Si e përjetoni respektin dhe vlerësimin që merrni nga ish-studentët tuaj?

Është një nga shpërblimet më të mëdha të jetës sime profesionale. Kur sheh ish-studentët, që sot janë pedagogë, drejtues apo specialistë të suksesshëm dhe vazhdojnë të të kujtojnë me respekt, ndihesh i realizuar.

Çfarë mesazhi do t’u përcillnit të rinjve që duan të ndjekin shkencat ekzakte dhe të kontribuojnë në Forcat e Armatosura?

Të punojnë fort dhe të mos kenë frikë nga vështirësitë. Shkencat ekzakte zhvillojnë mendimin kritik, logjikën dhe aftësinë për të zgjidhur probleme. Këto janë cilësi të domosdoshme për çdo profesionist dhe veçanërisht për oficerët e ardhshëm.

Nëse do ta përmbledhnit gjithë eksperiencën tuaj akademike dhe njerëzore me një mesazh për studentët e Akademisë së Forcave të Armatosura, cili do të ishte ai?

Synoni të bëheni oficerë të aftë, profesionistë të zotë dhe qytetarë me integritet. Të jeni të përgatitur jo vetëm në aspektin ushtarak, por edhe në dijet shkencore, në kulturë dhe në formimin njerëzor. Vetëm kështu do të jeni të denjë për t’i shërbyer vendit dhe për të përballuar me sukses sfidat e kohës.

KATËR SHTYLLA TË LETËRSISË SHQIPTARE: KUR SHKRIMTARËT NDËRTOJNË KOMBIN

FISHTA, ASDRENI, LASGUSHI
DHE KOLIQI, KATËR ZËRA QË
FORMËSUAN SHPIRTIN SHQIPTAR

Një komb i shkruar me fjalë dhe shpirt

Historia e një kombi nuk shkruhet vetëm me data dhe beteja, por edhe me vargje, ide dhe ndjenja që kalojnë breza të tërë. Në kulturën shqiptare, letërsia nuk ka qenë thjesht art, por një formë rezistence, një mënyrë për të ruajtur identitetin dhe për të ndërtuar vetëdijen kombëtare.

Në këtë rrugëtim të gjatë kulturor, katër figura qëndrojnë si shtylla të pashkëputura të mendimit dhe shpirtit shqiptar: **At Gjergj Fishta, Aleksandër Stavre Drenova (Asdreni), Lasgush Poradeci dhe Ernest Koliqi**. Secili prej tyre përfaqëson një dimension të veçantë të shqiptarizmit: epikën, lirinë, ndjeshmërinë dhe modernitetin. Së bashku, ata nuk janë thjesht autorë, janë arkitektë të identitetit kombëtar.

Fishta - Epika e qëndresës dhe krenarisë kombëtare

Në qendër të kësaj galerie të madhe qëndron At Gjergj Fishta, autor i veprës monumentale “Lahuta e Malcis”, një epopë që shkon përtej letërsisë dhe shndërrohet në një kujtesë kolektive të shqiptarëve.

Fishta nuk shkroi vetëm poezi; ai ndërtoi një mit kombëtar mbi bazën e historisë dhe qëndresës shqiptare. Në vargjet e tij, shqiptari nuk është viktimë e historisë, por subjekt i saj, luftëtar, mbrojtës dhe ruajtës i identitetit.

Në një kohë kur kombi shqiptar kërkonte të afirmohej në hartën politike të Europës, Fishta i dha atij një armë të fuqishme: **fjalën e kthyer në epikë**.

Ai lartësoi trimërinë, besën dhe shpirtin e pavarësisë, duke e bërë letërsinë një formë të vetëdijes kombëtare.

Asdreni – Zëri i lirisë dhe i shtetit shqiptar

Në krah të Fishtës qëndron Aleksandër Stavre Drenova, i njohur si Asdreni, poeti që i dha zë aspiratës më të madhe të shqiptarëve: lirisë dhe shtetformimit.

Ai është autori i vargjeve të **Himnit Kombëtar Shqiptar**, një tekst që nuk është thjesht poezi, por një betim kolektiv i një populli për të ekzistuar si i lirë dhe i pavarur.

Ndryshe nga epika e së kaluarës, Asdreni shkruan për të ardhmen. Në vargjet e tij ndjehet thirrja për unitet, për përparim dhe për një Shqipëri që ngrihet mbi themelet e dinjitetit dhe shpresës. Ai nuk është vetëm poet, është zëri i një kombi në lindje.

Lasgush Poradeci - Shpirti i thellë i ndjeshmërisë shqiptare

Në një dimension krejt tjetër, por po aq thelbësor, qëndron Lasgush Poradeci, poeti i shpirtit të brendshëm dhe i lidhjes së pandashme me natyrën.

Ndërsa Fishta flet me ton epik dhe Asdreni me ton kombëtar, Lasgushi flet me heshtjen e shpirtit. Poezia e tij nuk është thirrje, por meditim; nuk është betejë, por reflektim.

Liçeni, mali, qielli dhe natyra në përgjithësi në poezinë e Lasgushit nuk janë thjesht elemente peizazhi, por pasqyra të shpirtit njerëzor.

Ai i dha letërsisë shqipe një dimension filozofik dhe universal, duke e lidhur atë me ndjeshmërinë më të thellë të qenies njerëzore.

Ernest Koliqi - Ndërtuesi i urave kulturore dhe modernitetit

Në këmbë mes këtyre figurave qëndron Ernest Koliqi, një nga personalitetet më të rëndësishme të kulturës dhe arsimit shqiptar.

Koliqi nuk ishte vetëm shkrimtar dhe përkthyes, por edhe reformator i mendimit kulturor. Ai kontribuoi fuqishëm



në zhvillimin e arsimit dhe në përhapjen e gjuhës shqipe si instrument i dijes dhe kulturës.

Përmes veprës së tij, ai krijoi ura mes traditës dhe modernitetit, mes Shqipërisë dhe botës, duke e bërë kulturën shqiptare më të hapur dhe më të organizuar.

Ai përfaqëson intelektualin që nuk mjaftohet me krijim, por angazhohet në ndërtim.

Një mozaik identiteti, katër rrugë, një komb

Nëse i shohim së bashku, këta katër autorë përfaqësojnë katër shtylla të identitetit shqiptar: **Fishta** – kujtesa historike dhe epika e qëndresës.

Asdreni – liria dhe aspirata kombëtare. **Lasgushi** – ndjeshmëria dhe universi shpirtëror. **Koliqi** – modernizimi dhe ndërtimi kulturor

Kjo nuk është vetëm letërsi. Është një sistem vlerash që ka formësuar mënyrën si shqiptarët mendojnë për veten e tyre, pa Fishtën, mungon kujtesa heroike, pa Asdrenin, mungon thirrja për liri, pa Lasgushin, mungon shpirti, pa Koliqin, mungon struktura kulturore. Së bashku, ata krijojnë një identitet të plotë.

Letërsia si themel i kombit

Në kohën e sotme, kur kultura shpesh reduktohet në konsum të shpejtë dhe informacion sipërfaqësor, rikthimi te këta autorë nuk është vetëm akt kulturor, është akt vetëdijeje.

Ata na kujtojnë se kombi nuk ndërtohet vetëm me institucione politike, por me ide, me gjuhë dhe me kulturë.

Letërsia e tyre nuk është e mbyllur në të kaluarën. Ajo vazhdon të flasë edhe sot, duke na kujtuar se identiteti nuk është i dhënë një herë e përgjithmonë, ai ndërtohet, ruhet dhe mbrohet çdo ditë.

Trashëgimia që vazhdon të jetojë

Fishta, Asdreni, Lasgushi dhe Koliqi nuk janë thjesht emra në historinë e letërsisë shqiptare. Ata janë katër mënyra për të kuptuar se çfarë do të thotë të jesh shqiptar: të kujtosh, të ëndërrosh, të ndjesh dhe të ndërtosh.

Mesazhi i tyre i përbashkët mbetet i qartë dhe i fuqishëm: një komb jeton aq sa jeton kultura e tij, dhe kultura jeton aq sa lexohet, kuptohet dhe vazhdohet.

RAMAZAN ZELIJA, EMRI QË U BË SHKOLLË PËR BREZA TË TËRË

Ka njerëz që dallohen për detyrat që kryejnë dhe ka të tjerë që mbahen mend për gjurmët që lënë te njerëzit. Ramazan Zelija i përket kategorisë së dytë. Për më shumë se pesë dekada, emri i tij është lidhur ngushtë me edukimin fizik ushtarak, sportin, formimin e brezave të rinj dhe promovimin e vlerave njerëzore në Forcat e Armatosura.

I njohur si pedagog, trajner, instruktor dhe organizator i aktiviteteve sportive, ai mbetet një nga figurat më të respektuara të sportit ushtarak shqiptar. Për shumë breza oficerësh dhe kadetësh, Ramazan Zelija nuk ka qenë thjesht pedagogu i përgatitjes fizike, por një model disipline, korrektësie dhe përkushtimi.

Shokët dhe kolegët e tij e përshkruajnë me pak fjalë, por me shumë domethënie: “Të qenit njeri, i tejkalon të gjitha dekoratat dhe titujt”. Dhe në rastin e tij, kjo nuk është thjesht një shprehje mirësjelljeje. Është përmbledhja e një jete të tërë në shërbim të ushtrisë, sportit dhe rinisë shqiptare.

Nga “Skënderbeu” drejt auditorëve ushtarakë

I lindur në Tiranë, më 11 qershor 1954, në një familje të njohur për punë dhe ndershmëri, Ramazan Zelija u rrit me vlerat e përkushtimit dhe të përgjegjësisë. Në vitin 1969 ai veshi uniformën e nxënësit skënderbegas, duke nisur një rrugëtim që do të lidhej përgjithmonë me institucionet ushtarake shqiptare. Pas përfundimit me sukses të Shkollës Ushtarake “Skënderbej”, vijoi studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në degën e fizikulturës, ku u dallua për rezultate të larta.

Formimi i tij profesional do të pasurohej më tej me studime universitare, kualifikime pasuniversitare dhe specializime të shumta në fushën e edukimit fizik, sportit, fizioterapisë dhe arteve marciale. Por diploma më e rëndësishme për të ishte ajo që fitonte çdo ditë në auditor, në fushën sportive dhe në marrëdhëniet me studentët. Për më shumë se një dekadë e gjysmë, ai shërbeu si pedagog në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”, duke u bërë një nga figurat më të njohura të Katedrës së Përgatitjes Fizike. Mijëra oficerë që kaluan në auditorët e kësaj shkolle kujtojnë edhe sot kërkesën profesionale, seriozitetin dhe përkushtimin e pedagogut Ramazan Zelija.

Një jetë mes ushtrisë dhe sportit

Karriera e tij profesionale përfshin detyra të rëndësishme në Forcat e Armatosura, si instruktor i përgatitjes fizike, specialist në Ministrinë e Mbrojtjes, pedagog në Akademinë



RAMAZAN ZELIJA, mjeshtri i edukimit fizik ushtarak

Ushtarake “Skënderbej”, specialist në Forcat Speciale dhe më pas pedagog në Akademinë e Forcave të Armatosura. Në të gjitha këto detyra ai ka mbetur i lidhur me një mision të pandryshueshëm: përgatitjen fizike dhe morale të ushtarakut shqiptar.

Kontributi i tij shtrihet në shumë drejtime. Ai ishte ndër specialistët që punuan për modernizimin e programeve të përgatitjes fizike në Forcat e Armatosura, për futjen e elementeve të arteve marciale në stërvitjen ushtarake, si dhe për zgjerimin e sporteve me karakter ushtarak.

Po aq i rëndësishëm mbetet edhe roli i tij në anëtarësimin e Forcave të Armatosura në CISM, organizatën më të madhe ndërkombëtare të sportit ushtarak, duke hapur një kapitull të ri në përfaqësimin sportiv të ushtrisë shqiptare.

“Mësuesi” i karateistëve shqiptarë

Nëse në ushtri njihet si pedagog i përgatitjes fizike, në botën sportive Ramazan Zelija njihet si një nga pionierët dhe

figurat më të rëndësishme të karatesë shqiptare. Për më shumë se tri dekada ai ka drejtuar ekiye sportive të njohura si “Partizani”, “Dinamo”, “Geraldina”, “Dardania” dhe “Studenti”, duke përgatitur sportistë që kanë fituar tituj kombëtarë dhe kanë përfaqësuar Shqipërinë në arenën ndërkombëtare.

Nën drejtimin e tij, ekipet që ai trajnoi u shpallën disa herë kampione kombëtare, ndërsa dhjetëra sportistë të rinj u formuan jo vetëm si kampionë, por edhe si qytetarë të denjë. Nuk është rastësi që shumë mjeshtër dhe trajnerë të arteve marciale në Shqipëri e konsiderojnë Ramazan Zelinë si një nga mësuesit e tyre të parë. Përkushtimi ndaj brezit të ri dhe aftësia për të transmetuar dije e përvojë e kanë bërë atë një figurë të veçantë në historinë e sportit shqiptar.

Kujtesa që nuk shuhet kurrë

Në jetën e Ramazan Zelisë ka edhe një kapitull që mbetet i paharruar. Është ngjarja tragjike e 6 shkurtit 1981 në Fekën, kur një ortek dëbore goditi kolonën stërvitore të studentëve dhe pedagogëve të Shkollës së Bashkuar.



Ajo ditë e rëndë mori jetën e tre oficerëve dhe tetë studentëve, të cilët më vonë u shpallën “Dëshmorë të Atdheut”.

Ramazan Zelija ishte pjesë e atij brezi pedagogësh që përjetuan nga afër tragjedinë. Për të dhe kolegët e Katedrës së Përgatitjes Fizike, emrat e Çlirim Pulajt, Nikollaq Beros, Dushan Shametit dhe tetë studentëve të rënë mbeten pjesë e pandarë e kujtesës së institucionit. Në çdo përvjetor, në çdo takim mes kolegësh, kujtimi i tyre rikthehet si një apel nderi për ata që sakrifkuan jetën gjatë kryerjes së detyrës.

Një jetë e mbushur me vlerësime

Kontributi i Ramazan Zelisë është vlerësuar me dekorata, medalje dhe certifikata mirënjohjeje, ndër të cilat “Medalja e Punës”, “Ylli i Kuq” i Klasisit III dhe vlerësime të shumta nga institucionet ushtarake dhe sportive.

Megjithatë, ata që e njohin prej vitesh janë të bindur se vlerësimi më i madh për të nuk qëndron te medaljet apo titujt. Ai qëndron te respekti që gëzon mes kolegëve, nxënësve dhe sportistëve që ka formuar.

Sot, pas më shumë se pesëdhjetë vitesh aktivitet, Ramazan Zelija vazhdon të mbetet një figurë referimi për sportin ushtarak dhe artet marciale shqiptare. Jeta dhe veprimtaria e tij dëshmojnë se profesionalizmi, pasioni dhe përkushtimi ndaj njerëzve janë vlera që nuk humbasin kurrë. Dhe pikërisht për këtë arsye, emri i tij vazhdon të përmendet me respekt si pedagogu që formoi breza ushtarakësh dhe trajneri që edukoi kampionë.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Forca e padukshme pas çdo familjeje të fortë

Në historinë e njerëzimit janë shkruar mijëra libra për luftërat, pushtetet, fitoret dhe heronjtë. Janë ngritur monumente për mbretër, komandantë dhe burra shteti. Por shumë më pak është folur për ata njerëz që, pa bujë dhe pa kërkuar lavdi, kanë mbajtur gjallë familjen, kanë rritur brezat dhe kanë ruajtur vlerat mbi të cilat ndërtohet shoqëria.

Në qendër të kësaj bote qëndron gruaja.

Ajo nuk ka nevojë për podiume për të treguar madhështinë e saj. Nuk ka nevojë për duartrokitje për të dëshmuar vlerën që mbart. Kontributi i saj matet me dashurinë që jep, me sakrificat që bën dhe me gjurmët që lë në jetën e atyre që e rrethojnë.

Gruaja është zemra e familjes.

Ajo është ajo që zgjohet më herët dhe shpesh fle më vonë. Ajo është ajo që gjen forcë edhe kur lodhja e ka pushtuar. Ajo është ajo që i vendos nevojat e të tjerëve përpara të sajave dhe që e sheh lumturinë e familjes si lumturinë e vet.

Në çdo familje të suksesshme, në çdo histori të bukur jete, pas çdo burri të realizuar dhe pas çdo fëmije të edukuar mirë, qëndron shpesh dora e një gruaje që ka ditur të japë pa kërkuar shpërblim.

Shoqëria moderne ka ndryshuar shumë. Gruaja sot është pjesë aktive e jetës ekonomike, sociale, kulturore dhe politike. Ajo drejton institucione, universitete, kompani dhe organizata. Ajo konkurron me dinjitet në çdo fushë të jetës publike.

Megjithatë, pavarësisht këtyre ndryshimeve, një gjë mbetet e pandryshuar: roli i saj i pazëvendësueshëm në familje. Asnjë teknologji nuk mund të zëvendësojë ngrohtësinë e një nëne.

Asnjë sistem nuk mund të zëvendësojë përkushtimin e një bashkëshorteje.

Asnjë pasuri nuk mund të blejë dashurinë e sinqertë që një grua i jep familjes së saj.

Pikërisht këtu qëndron madhështia e saj. Jo në zhurmën e suksesit, por në heshtjen e sakrificës.

Historia shqiptare është e mbushur me shembuj grash të forta.

Nga nënat që rritën fëmijët në kohë lufte e varfërie, deri te gratë që mbajtën familjet në këmbë gjatë emigracionit masiv të viteve të tranzicionit. Ato nuk u shfaqën në kronika televizive. Nuk dolën në tribunat politike. Nuk kërkuan dekorata. Por ato mbajtën gjallë familjen shqiptare. Ruajtën gjuhën, traditën, zakonet dhe edukimin.

Ato i mësuan brezit të ri respektin për prindërit, dashurinë për punën dhe ndershmërinë.

Në shumë raste, ato ishin heroina të heshtura që nuk kërkuan kurrë të quheshin të tilla.

Bashkëshortja zë një vend të veçantë në jetën e çdo njeriu.

Ndryshe nga lidhjet e gjakut, martesë është një zgjedhje. Dy njerëz vendosin të ecin së bashku në të njëjtën rrugë, të ndajnë të njëjtat sfida dhe të ndërtojnë të njëjtën të ardhme. Kjo zgjedhje kërkon durim.

Kërkon respekt. Kërkon mirëkuptim. Kërkon sakrificë. Në ditët e mira është e lehtë të jesh pranë dikujt. Vlera e vërtetë e një bashkëshorteje shfaqet në ditët e vështira. Kur familja përballlet me probleme. Kur ekonomia tronditet. Kur shëndeti lëkundet. Kur ëndrrat duken larg. Atëherë shfaqet forca e saj.

Atëherë kuptohet se sa e rëndësishme është prania e saj. Atëherë zbulohet se familja nuk mbahet vetëm nga muret e shtëpisë, por nga zemrat e atyre që jetojnë brenda saj.

Në kohën tonë, kur ritmi i jetës është bërë më i shpejtë dhe marrëdhëniet njerëzore shpesh po humbasin thellësinë e dikurshme, është e nevojshme të rikthejmë vëmendjen te vlerat themelore. Respekti për gruan është një prej tyre. Nuk mjafton ta vlerësosh vetëm në ditë festash. Nuk mjafton një lule apo një urim. Vlerësimi i vërtetë shfaqet në



përditshmëri. Në dëgjimin e fjalës së saj. Në mbështetjen e saj. Në ndarjen e përgjegjësisë. Në respektimin e dinjitetit të saj. Në mirënjohjen për gjithçka që ajo bën. Sepse shumë gjëra që duken të zakonshme në jetën familjare janë në fakt rezultat i përkushtimit të saj të përditshëm.

Familja mbetet institucioni më i rëndësishëm i shoqërisë. Dhe në qendër të saj qëndron gruaja. Ajo është edukatorja e brezave.

Ruajtësja e vlerave. Burimi i dashurisë. Forca e qëndrueshmërisë.

Ajo është ura që lidh të shkuarën me të ardhmen. Ajo është kujtesa e familjes dhe shpresa e saj. Për këtë arsye, nderimi ndaj gruas nuk është vetëm detyrim moral ndaj saj. Është respekt ndaj vetë jetës.

Sepse aty ku gruaja respektohet, familja bëhet më e fortë. Aty ku familja bëhet më e fortë, shoqëria bëhet më e shëndetshme. Aty ku shoqëria është e shëndetshme, kombi ka të ardhme.

Shumë prej fitoreve që shohim në jetë kanë një autorësi të heshtur.

Ato mbajnë emrin e një gruaje që ka ditur të jetë pranë, të mbështesë, të durojë dhe të besojë.

Prandaj gruaja nuk është thjesht pjesë e historisë së familjes.

Ajo është zemra që e shkruan atë histori çdo ditë.

Në çdo shoqëri, uniforma ushtarake ka qenë simbol i disiplinës, sakrificës dhe përgjegjësisë. Por kur ajo vishet nga gratë, ajo merr edhe një dimension tjetër, qëndrueshmërinë e heshtur, vendosmërinë për të thyer kufij dhe aftësinë për të mbajtur barrën e shërbimit pa humbur humanitetin.

Sot, gjithnjë e më shumë vajza të reja në Shqipëri dhe më gjerë po zgjedhin të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura. Ky nuk është më një realitet i rrallë apo simbolik; është një prikje që tregon ndryshimin e rolit të gruas në shoqëri dhe në strukturat e sigurisë.

Një zgjedhje që nuk kërkon lavdi, por qëllim

Të veshësh uniformën ushtarake nuk është një vendim i lehtë. Nuk është një profesion i zakonshëm që matet vetëm me orar pune apo pagë mujore. Është një angazhim ndaj shtetit, ndaj qytetarëve dhe shpesh edhe ndaj situatave që kërkojnë sakrificë personale.

Për shumë vajza të reja, kjo zgjedhje nuk lidhet me kërkimin e lavdisë. Ajo lidhet me diçka më të thellë: dëshirën

për të qenë e dobishme, për të ndërtuar disiplinë personale dhe për të qenë pjesë e një strukture që ka mision mbrojtjen.

Gruaja në uniformë, forcë dhe ekuilibër

Pjesëmarrja e grave në ushtri nuk është thjesht një çështje përfaqësimi. Ajo sjell një balancë të rëndësishme në mënyrën se si funksionojnë strukturat ushtarake. Gratë sjellin shpesh aftësi të forta në menaxhimin e situatave të tensionuara, në punën në grup dhe në qëndrueshmërinë emocionale në kushte të vështira.

Uniforma nuk e zbeh feminitetin; përkundrazi, e vendos atë në një kontekst ku forca nuk matet vetëm me muskuj, por edhe me vendosmëri, përqendrim dhe integritet.

Rruga e vështirë e formimit

Rruga drejt ushtrisë kërkon përgatitje fizike, mendore dhe disiplinore. Trajnimet janë intensive dhe kërkojnë përkushtim të vazhdueshëm. Çdo ditë është një test i kufijve personalë: durimi, rezistenca, bashkëpunimi dhe aftësia për të ndjekur rregulla strikte.

Për vajzat që hyjnë në këtë rrugë, sfida më e madhe shpesh nuk është fizike, por mendore, tejkalimi i paragjykimeve dhe pritshmërive shoqërore që për një kohë të gjatë e kanë parë ushtrinë si një terren kryesisht mashkullor.

Thyerja e stereotipave

Sot, realiteti është ndryshe. Gratë shërbejnë në role të ndryshme brenda forcave të armatosura, nga logjistika dhe mjekësia ushtarake, deri te pozicionet operationale dhe drejtuese. Ky transformim nuk ka ndodhur rastësisht, është rezultat i përpjekjes, profesionalizmit dhe aftësisë për të dëshmuar vlerë në terren.

Çdo vajzë që vesh uniformën kontribuon në thyerjen e një stereotipi të vjetër dhe në ndërtimin e një standardi të ri profesional.

Për vajzat që mendojnë të bëhen pjesë e ushtrisë, rruga nuk është e thjeshtë, por është e ndërtuar mbi mundësi reale zhvillimi. Ajo kërkon disiplinë, vendosmëri dhe gatishmëri për të mësuar vazhdimisht.

Por në këmbim, ofron diçka që pak profesione e japin: ndjenjën e përkatësisë ndaj një misioni më të madh se vetja.

Gruaja në uniformë nuk është thjesht një grua në uniformë. Ajo është dëshmi se forca nuk ka një formë të vetme, dhe se guximi shpesh vjen në heshtje, pa kërkuar lavdi.

Siguria kibernetike është shndërruar në një nga shtyllat kryesore të mbrojtjes kombëtare. Lufta nuk zhvillohet më vetëm në tokë, det apo ajër — ajo ka hyrë në një dimension të ri, atë të hapësirës digjitale. Çdo ushtri moderne është e varur nga sisteme të automatizuara, rrjete të ndërlydhura dhe inteligjencë artificiale, duke e bërë kibernetikën një fushë betejë të re, ku fitoret dhe humbjet mund të ndodhin pa asnjë të shtënë arme.

Një fushë e re lufte

Siguria kibernetike ka një rol të dyfishtë: mbrojtës dhe ofensiv. Nga njëra anë, ajo synon të mbrojë sistemet e armëve, komunikimet e komandës dhe kontrollit, si dhe infrastrukturën kritike nga sulmet e kundërshtarëve. Nga ana tjetër, shtetet e fuqishme zhvillojnë kapacitete për të ndërmarrë sulme kibernetike që mund të paralizojnë rrjetet e armikut, të çaktivizojnë sistemet e mbrojtjes ajrore apo të manipulojnë informacionin e inteligjencës. Kjo e bën kibernetikën një mjet strategjik, po aq të rëndësishëm sa avionët luftarakë apo raketat balistike.

Një sulm kibernetik mund të ketë pasoja të ngjashme me një bombardim fizik. Një ndërhyrje e suksesshme në sistemet e komunikimit të një ushtrie mund të shkaktojë kaos, të ndërpresë zinxhirin e komandës dhe të paralizojë operacionet në terren. Prandaj, shumë vende e konsiderojnë sigurinë kibernetike si “armën e padukshme” të shekullit XXI.

NATO dhe dimensionin ndërkombëtar

NATO e ka shpallur kibernetikën si një “domain operativ” më vete, duke e barazuar me tokën, detin, ajrin dhe hapësirën. Ky vendim historik tregon se aleanca e sheh sigurinë digjitale si një element të domosdoshëm për mbrojtjen kolektive. Përmes stërvitjeve të rregullta dhe krijimit të qendrave të specializuara, NATO synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe aftësinë për të reaguar ndaj sulmeve të sofistikuar.

Aleanca ka krijuar Qendrën e Integruar të Mbrojtjes Kibernetike, e cila koordinon mbrojtjen e rrjeteve të NATO-s dhe ndihmon vendet anëtare të forcojnë kapacitetet e tyre kombëtare. Përmes “Cyber Defence Pledge”, shtetet anëtare janë zotuar të investojnë në sigurinë e infrastrukturave kritike dhe të zhvillojnë politika të përbashkëta për reagim ndaj incidenteve kibernetike. Edhe Shtetet e Bashkuara, përmes U.S. Cyber Command, kanë integruar inteligjencën artificiale në operacionet e tyre për të analizuar dhe neutralizuar kërcënimet në kohë reale.

Sfida dhe dobësi

Me gjithë përparimet, sfidat mbeten të shumta. Shumë sisteme ushtarake përdorin komponentë komercialë, gjë që i bën të prekshëm ndaj dobësive të njohura. Raportet e instituteve kërkimore si RAND kanë theksuar se shpesh mungon një plan i integruar për sigurinë kibernetike gjatë gjithë ciklit jetësor të armëve. Një dron apo një sistem raketor mund të ketë dobësi të fshehura që mund të shfrytëzohen nga kundërshtarët.

Një tjetër problem është mungesa e standardeve të unifikuara ndërkombëtare. Çdo vend ka politikat e veta, por mungesa e koordinimit global e bën të vështirë reagimin ndaj sulmeve transnacionale. Për më tepër, sulmet kibernetike nuk kërkojnë investime të mëdha; shpesh mjafton një grup i vogël ekspertësh për të shkaktuar dëme të mëdha. Kjo e bën fushën kibernetike një mjedis ku edhe aktorët jo-shtetërorë mund të kenë ndikim të konsiderueshëm.

Zgjidhjet dhe rruga përpara

Zgjidhja qëndron në integrimin e sigurisë që në fazën e projektimit të teknologjisë ushtarake. Ushtritë moderne duhet të investojnë në trajnime të vazhdueshme, në partneritete me universitete dhe kompani teknologjike, si dhe në zhvillimin e protokolleve të përbashkëta ndërkombëtare. Edukimi i personelit ushtarak është po aq i rëndësishëm: siguria kibernetike duhet të jetë pjesë e kulturës së çdo institucioni ushtarak. Vetëm përmes ndërgjegjësimit të gjerë mund të krijohet një mbrojtje e qëndrueshme.

Inteligjenca artificiale dhe siguria kibernetike

Në dekadën e fundit, inteligjenca artificiale (IA) është shndërruar në një faktor vendimtar për zhvillimin e teknologjisë ushtarake. Ajo përdoret për të analizuar sasi të mëdha të dhënash, për të zbuluar sulme kibernetike në kohë reale dhe për të parashikuar dobësitë e sistemeve përpara se ato të shfrytëzohen. IA është një “radar digjital” që nuk

KIBERNETIKA SI ARMA E PADUKSHME

Inteligjenca Artificiale dhe Siguria Ushtarake në Shekullin XXI



pushon kurrë, duke ofruar mbrojtje të vazhdueshme dhe të automatizuar.

Por IA ka edhe rol ofensiv. Algoritmet e avancuara mund të depërtojnë në sistemet e armikut, të manipulojnë informacionin dhe të paralizojnë infrastrukturën kritike. Kjo e kthen IA në një armë të re, po aq të fuqishme sa raketat apo avionët luftarakë. Në këtë kontekst, siguria kibernetike dhe inteligjenca artificiale janë të ndërvarrura: pa IA, mbrojtja digjitale është e kufizuar; pa siguri kibernetike, IA mund të kthehet në një rrezik.

Etika dhe dilemat

Përdorimi i IA në ushtri ngre dilema të mëdha etike. A duhet t'i besohet një algoritmi vendimarrja për jetën dhe vdekjen? Çfarë ndodh nëse një sistem i automatizuar merr një vendim të gabuar? Këto pyetje janë pjesë e debatit global mbi “armët autonome”. NATO dhe organizata të tjera ndërkombëtare po diskutojnë rregulla për përdorimin e IA në luftë, por shumë shtete po investojnë në zhvillimin e armëve autonome, duke e bërë të vështirë vendosjen e kufijve etikë.

Ndërvarrësia me sigurinë kombëtare dhe ekonominë

Siguria kibernetike dhe IA ndikojnë jo vetëm në ushtri, por edhe në ekonominë dhe stabilitetin politik të një vendi. Një sulm kibernetik mund të paralizojë bankat, rrjetet energjetike apo sistemet e transportit. Kjo e bën mbrojtjen digjitale një çështje kombëtare, jo vetëm ushtarake.

Roli i vendeve të vogla dhe Shqipërisë

Për vendet e vogla si Shqipëria, siguria kibernetike është një sfidë e madhe, por edhe një mundësi për zhvillim. Pjesëmarrja në programe ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me aleatët është jetik për ndërtimin e kapaciteteve mbrojtëse. Shqipëria, si vend anëtar i NATO-s, ka filluar të ndërtojë strukturat e veta për mbrojtjen kibernetike, por nevojitet më shumë investim në burime njerëzore dhe teknologji. Përmes bashkëpunimit me aleatët, ajo mund të ndërtojë kapacitete të reja, të trajtojë

ekspertë dhe të krijojë një kulturë të sigurisë kibernetike që shtrihet përtej ushtrisë, në çdo sektor të shoqërisë.

Lufta e padukshme dhe e ardhmja digjitale

Siguria kibernetike është arma e padukshme e shekullit XXI. Pa të, çdo teknologji ushtarake, sado e sofistikuar të jetë, mund të bëhet e pavlefshme. Lufta moderne nuk zhvillohet më vetëm me tanke dhe avionë, por edhe me algoritme, kode dhe rrjete. Kibernetika nuk është më thjesht një fushë teknologjike — ajo është zemra e mbrojtjes kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në këtë betejë të re, fiton ai që është më i përgatitur, më i informuar dhe më i bashkuar. Mbrojtja kibernetike nuk është vetëm një çështje e ushtrive të mëdha, por e çdo shteti që kërkon të ruajë pavarësinë dhe sigurinë e tij. Çdo sulm ndaj infrastrukturës digjitale mund të ketë pasoja të drejtpërdrejta në sigurinë kombëtare, ekonominë dhe stabilitetin politik. Prandaj, siguria kibernetike duhet të trajtohet si prioritet kombëtar, jo si një çështje teknike e izoluar.

Perspektiva për vendet e vogla

Për vendet e vogla, sfida është e madhe, por edhe mundësia është reale. Përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, investimit në teknologji dhe edukimit të brezave të rinj, siguria kibernetike mund të kthehet në një avantazh strategjik. Shqipëria, si vend anëtar i NATO-s, ka mundësinë të përfitojë nga programet e përbashkëta të mbrojtjes digjitale, duke ndërtuar kapacitete të reja dhe duke krijuar një kulturë të sigurisë që shtrihet përtej ushtrisë, në çdo sektor të shoqërisë.

Lufta e së ardhmes

Lufta e së ardhmes nuk do të fitohet vetëm me tanke dhe avionë, por me algoritme, kode dhe sisteme të zgjuara që mund të parashikojnë, mbrojnë dhe sulmojnë. Inteligjenca artificiale dhe siguria kibernetike janë dy anët e së njëjtës medalje: të ndërvarrura, të pandashme dhe vendimtare për mbrojtjen e shteteve moderne. Kush kontrollon hapësirën digjitale, kontrollon edhe fatin e betejave të së ardhmes.



Ndotja nga qymyri: Armiku i fshehtë i energjisë diellore

Premtimi i diellit dhe realiteti i errët

Energjia diellore është shpallur si një nga zgjidhjet më të fuqishme për krizën klimatike. Panelet fotovoltaike po mbulohen në çati, fusha dhe shkretëtira, duke u parë si simbol i një epoke të re të pastër. Por, ndërsa bota investon miliarda për të kapur fuqinë e diellit, një faktor i padukshëm po e saboton këtë përpjekje: ndotja e ajrit nga qymyri. Grimcat e imëta të lëshuara nga termocentralet jo vetëm që dëmtojnë shëndetin publik, por edhe bllokojnë rrezet e diellit, duke ulur ndjeshëm prodhimin e energjisë diellore.

Një raport i fundit i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë paralajmëron se “pa reduktimin e ndotjes, energjia diellore nuk do të arrijë kurrë potencialin e saj të plotë”. Ky është një alarm që nuk mund të injorohet.

Si e bllokoi ndotja diellin

Aerosolët: Grimcat e sulfurit dhe karbonit krijojnë një perde të padukshme në atmosferë. Kjo perde thith dhe shpërndan rrezet e diellit, duke ulur sasinë e energjisë që arrin tek panelet fotovoltaike.

Ndryshimi i reve: Aerosolët shërbejnë si bërthama kondensimi, duke krijuar re më të dendura dhe më reflektuese. Kjo rrit humbjet e insolacionit dhe e bën prodhimin diellor më të paqëndrueshëm.

Prof. Li Wei, ekspert i klimës në Universitetin e Pekinit, e përshkruan këtë fenomen si “një sabotim i dyfishtë: ndotja nga qymyri jo vetëm që ngroh planetin, por edhe e errëson diellin që mund të na shpëtojë”.

Humbjet e matshme: Statistika alarmante

Studimet e fundit tregojnë se në vitin 2023, humbjet globale të energjisë diellore për shkak të aerosoleve arritën në 111 TWh – ekuivalente me prodhimin e 18 termocentraleve mesatare me qymyr.

Në total, humbjet e insolacionit arrijnë deri në 26.9%, ku 21.1% vjen nga retë dhe pjesa tjetër nga ndotja. Midis viteve 2017–2023, humbjet vjetore nga ndotja ishin rreth 74 TWh, një shifër që përfaqëson afro një të tretën e energjisë së re të shtuar nga instalimet diellore.

Dr. Maria González, nga Universiteti i Madridit, thotë: “Këto humbje janë të barabarta me energjinë që mund të furnizonte miliona familje. Ndotja po na kushton jo vetëm shëndetin, por edhe energjinë e pastër”.

Shembuj rajonalë: Ku ndotja godet më fort

Kina: Si prodhuesi më i madh i energjisë diellore, Kina është edhe më e ekspozuar ndaj humbjeve. Kombinimi i kapacitetit të madh diellor dhe termocentraleve me qymyr e bën ndikimin të ndjeshëm. Politikat e pastrimit të ajrit që nga viti 2013 kanë ulur gradualisht efektin e aerosoleve, por sfida mbetet e madhe.

Evropa dhe SHBA: Humbjet janë më të ulëta, por trendi është në rritje. Djegia e fosileve vazhdon të ndikojë në atmosferë, duke ulur efikasitetin e parashikuar të energjisë diellore.

India: Një tjetër rast ku ndotja e lartë urbane dhe industriale po dëmton potencialin e madh diellor të vendit. Në Delhi, panelet fotovoltaike prodhojnë deri në 20% më pak energji gjatë periudhave të smogut.

Pasojat për tranzicionin energjetik

Nënvlerësim i kapacitetit diellor: Shumë projeksione optimiste për energjinë diellore nuk marrin parasysh humbjet nga ndotja, duke krijuar pritshmëri të rreme.

Ndikim i dyfishtë: Djegia e qymyrit jo vetëm që rrit emetimet e karbonit, por edhe ul efikasitetin e energjisë së pastër – një sabotim i dyfishtë ndaj klimës.

Paradoksi i aerosoleve: Ndërsa dëmtojnë prodhimin

diellor, aerosolët reflektojnë rrezatimin diellor dhe ndihmojnë në ftohjen e Tokës. Ky paradoks e bën politikën klimatike edhe më komplekse, duke krijuar dilema për vendimmarrësit.

Çfarë duhet bërë?

Reduktimi i qymyrit: Zëvendësimi i termocentraleve me qymyr me burime të pastra është zgjidhja më e drejtpërdrejtë.

Politika të pastrimit të ajrit: Investimet në teknologji filtrimi dhe standarde më të rrepta për ndotjen mund të rrisin efikasitetin e energjisë diellore.

Diversifikimi i burimeve: Kombinimi i energjisë diellore me erën dhe hidroenergjinë mund të kompensojë humbjet e shkaktuara nga ndotja.

Inovacion teknologjik: Panelet fotovoltaike të gjeneratës së re, të dizajnuara për të absorbuar më shumë rrezatim difuz, mund të reduktojnë efektin e aerosoleve.

Lufta për diellin

Energjia diellore nuk është e dobët – por po sabotohet nga ajri i ndotur. Ndotja nga qymyri është një pengesë e madhe për tranzicionin energjetik dhe për objektivat klimatike globale. Çdo ton qymyr i djegur jo vetëm që shton karbon në atmosferë, por edhe ul fuqinë e diellit që mund të shfrytëzojmë.

Nëse duam një të ardhme të pastër, duhet të kuptojmë se lufta kundër qymyrit nuk është vetëm për klimën, por edhe për të çliruar potencialin e plotë të energjisë diellore. Siç e përmendi një ekspert i IPCC: “Çdo ditë që vonojmë reduktimin e qymyrit, humbasim jo vetëm kohë, por edhe diell”.



KUJTIM BORIÇI

“Skënderbegasi ndër vite”, një tjetër dëshmi e gjallë e traditës ushtarake shqiptare

Sarandë – Shoqata “Skënderbegasi” – Nderi i Kombit, Dega Sarandë, organizoi një veprimtari të veçantë kulturore dhe historike me rastin e promovimit të vëllimit të pestë të kolanës “Skënderbegasi ndër vite”, me autorë publicistin dhe poetin Kujtim Boriçi dhe studiuesin Maksi Fejzulla.

Aktiviteti u zhvillua nën përkujdesjen e kryetarit të Degës së Shoqatës “Skënderbegasi” në Sarandë, Përparim Xhaferri, dhe kryetarit të Shoqatës së Ushtarakëve të Sarandës, Subi Hida. Në të morën pjesë ish-skënderbegas, ushtarakë në lirim, intelektualë, drejtues të shoqatave patriotike, si dhe të ftuar nga Tirana dhe qytete të tjera të jugut të vendit. Të pranishëm ishin edhe autorët e veprës.

Duke hapur veprimtarinë, Përparim Xhaferri vlerësoi punën e autorëve për realizimin e një kolane tashmë të konsoliduar, e cila përmes pesë vëllimeve sjell historinë, traditat dhe kontributin shumëdimensional të ish-nxënësve të Shkollës Ushtarake “Skënderbej”.

“Me këtë vëllim, së bashku me katër paraardhësit, krijohet një tablo e plotë e historisë së shkollës sonë të dashur ‘Skënderbej’, e njohur për dekada si fidanishte e ushtrisë shqiptare. Në këto faqe pasqyrohen veprimtaria e pedagogëve, komanduesve dhe nxënësve skënderbegas, të cilët kanë lënë gjurmë të rëndësishme në historinë e Forcave të Armatosura dhe të vetë shtetit shqiptar”, - theksoi ai.

Gjatë prezantimit u evidentua fakti se vëllimi i pestë sjell një sërë dokumentesh historike, dëshmi, kujtime dhe materiale arkivore, disa prej të cilave publikohen për herë të parë. Sipas diskutuesve, autorët kanë realizuar një punë të kujdesshme hulumtuese, duke dokumentuar ngjarje, zhvillime dhe kontribute që lidhen ngushtë me historinë e arsimit ushtarak në vend.

Në fjalën e tij, Përparim Xhaferri ndaloi edhe te periudha e viteve të tranzicionit, duke kujtuar dokumente dhe zhvillime që lidhen me mbylljen e Shkollës Ushtarake “Skënderbej” në fillim të viteve ’90, një ngjarje që vijon të mbetet objekt diskutimesh dhe vlerësimesh mes brezave të ish-skënderbegasve.

“Skënderbegasi ndër vite”, vëllimi i pestë promovohet në Sarandë



Një vend të rëndësishëm në libër zënë edhe kontributet e skënderbegasve në rindërtimin dhe zhvillimin e vendit pas Luftës së Dytë Botërore. Përmes dokumenteve dhe kujtimeve të përfshira në vepër pasqyrohet pjesëmarrja e tyre në ndërtimin e veprave të rëndësishme kombëtare, si hekurudhat, akset rrugore, hidrocentralet, diga e Liqenit Artificial të Tiranës dhe shumë projekte të tjera me rëndësi ekonomike e sociale.

Diskutuesit vlerësuan faktin se autorët nuk janë fokusuar vetëm te figurat e njohura ushtarake, por kanë sjellë edhe portrete të dhjetëra ish-skënderbegasve që kanë shërbyer me përkushtim në detyra të ndryshme, duke ruajtur dinjitetin dhe vlerat e shkollës që i formoi.

Për librin dhe rëndësinë e tij dhanë vlerësimet e tyre Subi Hida, kryetar i Shoqatës së Ushtarakëve të Sarandës, Asllan Camaj, kryetar i Shoqatës “Labëria” për Sarandën, si

dhe Hambi Pervizi, Thoma Kardhashi, Pilo Andoni, Asllan Godo dhe pjesëmarrës të tjerë. Ata e cilësuan kolanën “Skënderbegasi ndër vite” një kontribut me vlera historike, dokumentare dhe edukative për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Në përmbyllje të aktivitetit, bashkautorit Kujtim Boriçi falënderoi organizatorët dhe pjesëmarrësit për interesimin dhe mbështetjen e vazhdueshme ndaj kësaj nisme botuese. Ai ndau me të pranishmit disa nga veçoritë e vëllimit të pestë, procesin e mbledhjes së materialeve dokumentare dhe projektet e ardhshme krijuese që synojnë të pasurojnë më tej fondin e botimeve kushtuar historisë së skënderbegasve.

Veprimtaria u zhvillua në një atmosferë të ngrohtë shoqërore dhe patriotike, duke u shndërruar në një takim vlerësimi për traditat e Shkollës Ushtarake “Skënderbej” dhe për kontributin e mijëra skënderbegasve në shërbim të Forcave të Armatosura dhe të Shqipërisë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**Bëhu pjesë e
strukturave të
mbrojtjes së vendit!**

QENDRA E
PERSONELIT
REKRUTIMIT

SHPALLJE PËR VEND VAKANT

Qendra e Personelit Rekrutimit
njofton se vazhdon procesi i
kompletimit me personel të
Tabelës së Organizimit dhe
Pajisjeve, për vendin e lirë të
punës në funksionin:

"SPECIALIST PËR REZERVËN"

Në Seksionin e Mobilizimit për
Forcat Tokësore, në Degën e
Mobilizimit, pranë Qendrës së
Personelit dhe Rekrutimit.

AFATI I APLIKIMIT:

Dorëzimi i dokumentacionit deri
më 11.06.2026.

INFORMACION I RËNDËSISHËM:

Kriteret e pranimit të
kandidatëve, dokumentet e
nevojshme për regjistrim, si dhe
procedurat përkatëse gjenden të
publikuara në faqen zyrtare të
institucionit, në seksionin
"Sektori i Website dhe Medias".

Një mundësi profesionale
në shërbim të sigurisë dhe
mobilizimit kombëtar.